



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHE

Nr. _____ Prot.

Lezhë, më ____/____/2026

Shtojca 14.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/enti Kontraktor në rastin e Marrëveshjes Kuadër)
**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË
AFATET E ANKIMIMIT**

Data 12/06/2026.

Drejtuar:

Operatorit Ekonomik (OE) ose

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE)

“KEGLI-DURI” Shpk, me Nuis K94016202U dhe me adrese Lagjja “Grumbullimit”, rruga e Laçit, pallat i ri, kati 1, zona kadastrale nr. 1664, me numer pasurie 3/426, Fushe Kruje, Kruje, Durres & “LIS KONSTRUKSION” Shpk, me Nuis K66613407H dhe me adrese Lagjja “Minatori”, Rruga e Spitalit, Pallati nr. 12, Shk.1, Kati 5, Ap.15, Bulqize, Diber.

OE “KEGLI-DURI” Shpk, me pjesëmarrje prej 85 %

OE “LIS KONSTRUKSION” Shpk, me pjesëmarrje prej 15 %

- OE/BOE me nënkontraktor

PO **JO**

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO **JO**

* * *

Tipi i Kontratës: Pune.

Lloji i Procedurës së Prokurimit: E Hapur.

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: REF-86134-05-19-2026.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Sistemimi dhe Rehabilitimi i perrenjeve, pritave malore dhe mureve mbrojtese ne Njesite Administrative Kallmet, Blinisht dhe Shengjin”.

Kohëzgjatja e kontratës: 12 Muaj nga data e nënshkrimit të Marrëveshjes Kuader.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 20/05/2026.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike: Buletini Nr. 33, datë 25 Maj 2026.

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Formulari bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse si më poshtë:

- 1- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “Colombo LTD” SH.P.K, me Nuis M31420052T & “ERAL CONSTRUCTION COMPANY” SH.P.K, me Nuis K82230002K dhe me oferte ekonomike 25,223,910.60 (njëzetë e pesë milion e dyqind e njëzet e tre mijë e nëntëqind e dhjetë pikë gjashtëdhjetë) Lek pa Tvsh,

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO JO

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

- 2- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “KEGLI-DURI” SH.P.K, me Nuis K94016202U & “LIS KONSTRUKSION” SH.P.K, me Nuis K66613407H dhe me oferte ekonomike 25,189,637 (njëzet e pesë milion e njëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e shtatë) Lek pa Tvsh,

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO JO

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

- 3- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “ASI INVEST” SH.P.K, me Nuis M01927023H & “UDHA” SH.P.K, me Nuis K77524909Q dhe me oferte ekonomike 19,676,431 (nëntëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e katerqind e tridhjetë e një) Lek pa Tvsh,

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO JO

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

- I- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “ASI INVEST” SH.P.K, me Nuis M01927023H & “UDHA” SH.P.K, me Nuis K77524909Q,**

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO JO X

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO X

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik rezulton se:

Se pari, Komisioni i Vleresimit të Ofertave pas kualifikimit të 2 ofertave të vlefshme bazuar në ligjin nr. 16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020“Për prokurimin publik”, në nenin 27, ku përcaktohet se: “Në nenin 93 pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje: “5. ***Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët***”, si dhe nenin 82/4, të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- Në rastin kur janë të vlefshme **dy ose më pak oferta**, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se **25% e fondit limit** të përlllogaritur;
- Në rastin kur janë të vlefshme **tri ose më shumë oferta**, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se **85% e mesatares së ofertave të vlefshme**.

verifikoi ofertat e kualifikuara të vlefshme nëse janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit ku rezultoi se vlera e **85% e mesatares së ofertave të vlefshme** është 19,858,827.27 Lek pa TVSH dhe çdo ofertë me vlerë më të ulët se vlera prej **19,858,827.27 lek konsiderohet anomalisht e ulët dhe duhet refuzuar pa kërkuar shpjegime** sipas ligjit nr. 16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020“Për prokurimin publik”.

Komisioni i Vleresimit të Ofertave krahasoi vlerat e ofertave të vlefshme me vlerën e **85% e mesatares së ofertave të vlefshme** ku nga krahasimi i këtyre ofertave rezultoi se oferta e paraqitur nga BOE “ASI INVEST” SH.P.K & “UDHA” SH.P.K, me vlerë prej **19,676,431** Lek pa TVSH, është ulur rreth **84% e mesatares së ofertave të vlefshme** dhe për rrjedhojë **është anomalisht e ulët dhe duhet refuzuar pa kërkuar shpjegime** bazuar kjo në nenin 27, të ligjit nr. 16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020“Për prokurimin publik”, si dhe nenin 82/4, të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Po ashtu, nga krahasimi i ofertës së BOE “ASI INVEST” SH.P.K & “UDHA” SH.P.K me vlerën e 75% të fondit limit (ulja **25% e fondit limit të përlllogaritur**), ku nga krahasimi i saj rezultoi se oferta e paraqitur nga BOE “ASI INVEST” SH.P.K & “UDHA” SH.P.K, me vlerë prej **19,676,431**

Lek pa TVSH, është ulur **30% nga fondi limit** dhe per rrjedhoje **është anomalisht e ulet dhe po ashtu duhet refuzuar pa kërkuar shpjegime** bazuar kjo në nenin 27, të ligjit nr. 16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenin 82/4, të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Sa më sipër, KVO konstaton se **oferta e BOE “ASI INVEST” SH.P.K & “UDHA” SH.P.K është në kundërshtim të nenit 27, të ligjit nr. 16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenin 82/4, të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, dhe duhet refuzuar për shkak të mosplotesimit të kriterëve ligjorë.**

Se dyti, KVO vëren se BOE nuk plotëson kriterin 2.3.10 të DST-se ku parashikohet se: *“Operatori ekonomik në rast se nuk është prodhues duhet të paraqesë kontratë e furnizimit për materialet si më poshtë:*

2.3.10/1 Hekur:

- Kontrata paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontratë furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

2.3.10/2 Per Materiale Inerte:

- Kontrata paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontratë furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

2.3.10/3 Per Beton:

- Kontrata paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontratë furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

2.3.10/4 Per Rrjete Gabion:

- Kontrata paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontratë furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

Nga analizimi i Dokumentave standarte të tenderit vërehet se për vendosjen e këtij kriteri Autoriteti Kontraktor është bazuar në zërat e preventivit të punimeve që do të realizohen dhe rendesise të vecante të objektit të prokurimit duke vlerësuar si të nevojshme që mallrat që do të përdoren në realizimin e punimeve të furnizohen nga prodhues apo distributor të autorizuar, kjo në përputhje

me kërkesat ligjore të parashikuara në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në nenin 39, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

Sa analizuam me siper dhe pas shqyrtimit të kriterit dhe qëllimit të vendosjes së tij nga ana e Autoritetit Kontraktor, KVO verën se për përmbushjen e këtij kriteri OE-te në rast se ***nuk janë prodhues*** duhet të paraqesin për ***“Hekurin”, kontratë paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar***.

Në rast paraqitje kontratë furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/ aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

KVO thekson se nga verifikimi i dokumentacionit në SPE rezulton se nuk është paraqitur nga anetaret e BOE-se asnjë kontratë paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar për ***“Hekurin”***

KVO verën se në SPE është paraqitur një dokument në gjuhë të huaj ku i referohet paleve të treta, por në këtë dokument nuk është cituar emri i anetareve të BOE “ASI INVEST” SH.P.K & “UDHA” SH.P.K dhe për rrjedhojë ky kriter konsiderohet i përmbushur.

Për sa përjashtim me lart, sjellim në vëmendje se edhe **Komisioni i Prokurimit Publik në vendimin Nr. 825/2021**, gjykon se për të përmbushur qëllimin e vendosjes së kriterit duhet të parashikohen forma apo dokumentacione alternative provuese të cilat vertetojnë lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit të autorizuar nga prodhuesi.

Gjithashtu **KPP** ka mbajtur të njëjtin qëndrim edhe në **vendimin Nr. 604/2019**, në të cilin thekson se : - ***“KPP gjykon se mungesa e dokumentit autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar nga prodhuesi nga kompanitë ADINNOL”, “CHAMPION”, “RAVENOL”, “CASTROL”, “MOTUOL”, “CYCLO” dhe “CHIMITEX, për të cilat janë paraqitur katalogë teknikë bën që dokumentacioni i paraqitur nga ankimuesi të mos jetë i plotë për përmbushjen e kriterëve kualifikuese të përcaktuara në procedurën e prokurimit objekt ankimi. Në rastin konkret nuk krijohet bindja mbi origjinalitetin e disa prej produkteve objekt prokurimi pasi për to janë paraqitur vetëm katalogë të prodhuesve të ndryshëm nga të cilët ankimuesi nuk ka asnjë autorizim apo dokument që të provojë lidhjen mes tyre”***

- ***“KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në këto rrethana, KPP gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga “Alstezo” sh.p.k. nuk është i plotë dhe i saktë dhe nuk krijon bindjen mbi origjinalitetin për një pjesë të mallrave objekt prokurimi”***.

Sa me sipër Komisioni i Vleresimit të Ofertave mbështetur nën 77, pikë 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve, si dhe në nenin 92, pikë 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, vendosi të refuzojë ofertën e BOE “ASI INVEST” SH.P.K & “UDHA” SH.P.K, për mos përmbushje të kriterëve të vecanta kualifikuese.

Si përfundim, në mbështetje të nenit 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, BOE “ASI INVEST” SH.P.K, me Nuis M01927023H & “UDHA” SH.P.K, me Nuis K77524909Q, skualifikohet.

* * *

Duke iu referuar procedurës së mësipërme, informojmë se, operatorët ekonomikë të mëposhtëm janë identifikuar si ofertues i sukseshëm:

1- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “KEGLI-DURI” SH.P.K, me Nuis K94016202U & “LIS KONSTRUKSION” SH.P.K, me Nuis K66613407H dhe me oferte ekonomike 25,189,637 (njëzet e pesë milion e njëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e shtatë) Lek pa Tvsh,

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO JO X

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO X

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
KRYETARI
Pjerin NDREU